



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**KOMISIONI VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK GRACKË E VJETËR**

Në mbështetje të nenit 17 dhe 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-15-463/02-17203, të dates 29.03.2024, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.15-020/01-17205, të dates 29.03.2024, për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK Grackë e Vjetër, Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit shpallë këtë:

**NJOFTIM**

**PËR ANULIMIN E NJOFTIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS Nr. 01-462/01-47698 TË DATËS 26.09.2024**

I. **NJOFTOHEN** të gjithë aplikuesit për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale me nr. të parcelës P-71409080-00007-0 ZK – Grackë e Vjetër, se procesi i vlerësimit të ofertave sipas Njoftimit publik Nr. 01-462/01-47698 të datës 26.09.2024 ka përfunduar duke mos rekomanduar asnjë fitues për shkak të mos kompletimit të dokumentacionit nga ofertuesit, përkatësisht kritereve administrative dhe teknike.

II. Puna e Komisionit sipas Njoftimit publik me Nr. 01-462/01-47698 të datës 26.09.2024 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për ZK – Grackë e Vjetër përfundon, prandaj edhe anulohen të gjitha veprimet juridike të ndërmarra përkitazi me këtë Njoftim publik.

III. Ky Njoftim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni Vlerësues.

**A r s y e t i m**

Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës P-71409080-00007-0 ZK në ZK Grackë e Vjetër, i themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-020/01-17205, të datës 29.03.2024, gjatë punës së tij ka analizuar në hollësi dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit dhe me këtë rast ka kostatuar se:

J.V. L.P. A.G. J.B. E.S

- Oferta e parashtruar me numër të protokolit 01-462/01-51456 nuk ishte e kompletuar administrativisht sipas kërkesave të Njoftimit publik Nr. 01-462/01-47698 të datës 26.09.2024, përkatësisht nuk kishte plotësuar kriteret sipas pikës IV/1 nr. rendor 1, 4 dhe 7 të Njoftimit publik. Gjithashtu, ofertuesi nuk ka prezantuar të dhënat sipas Kritereve teknike – pika IV/3 nr. 1/1.13 dhe numrit 2.

- Oferta e parashtruar me numër të protokolit 01-462/01-51441 nuk e përmbante projektin ideor sipas kërkesave të përcaktuara me Njoftimin publik, përkatësisht nuk i ka plotësuar kërkesat teknike sipas kritereve të përcaktuara me pikën IV/3 me nr. 1.1; 1.5; 1.13; dhe 1/14.

- Oferta e parashtruar me numër të protokolit 01-462/01-51451 nuk e përmbante projektin ideor sipas kërkesave të përcaktuara me Njoftimin publik, përkatësisht nuk i ka plotësuar kërkesat teknike sipas kritereve të përcaktuara me pikën IV/3, me nr. 1.1; 1.3; 1.5; 1.13; dhe 1/14. Po ashtu, ky ofertues nuk e ka paraqitur indeksin e ndërrimit të hapësirës në bodrum me banesë – pika 2 e kritereve teknike.

Bazuar në kërkesat e përcaktuara me Njoftimin publik dhe dokumentacionit të vlerësuar, Komisioni vlerësues ka përfunduar punën, duke mos rekomanduar asnjë fitues në pronën e caktuar – ZK Grackë e Vjetër dhe për këtë shkak ky proces anulohet.

Palët e pakënaqura nga procesi i shqyrtimit të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të Njoftimit kanë të drejtë të parashtrorjnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditëve kalendarike në Komisionin e ankesave.

Ky Njoftim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komunës dhe me të njejtin njoftohen ofertuesit të cilët kanë parashtruar ofertat në bazë të Njoftimit publik Nr. 01-462/01-47698 të datës 26.09.2024.

Nr: 01-462/01-1638

Datë: 09.01.2025


1. Imri Semetishti, Kryesues i Komisionit



2. Latif Ramadani, anëtar



3. Armend Grajqevci, anëtar



4. Lulzim Rrustemi, anëtar



5. Erëblina Salihu, anëtar

